



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
DEPARTAMENTI I STABILITETIT FINANCIAR

Raport¹

mbi ecurinë e treguesve që monitoron Banka e Shqipërisë, në kuadër të procesit të deeuroizimit

Gusht 2023

¹ Ky raport publikohet në zbatim të Memorandumit të Bashkëpunimit mes Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Bankës së Shqipërisë dhe Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, “Për zgjerimin e përdorimit të monedhës kombëtare në sistemin financiar dhe në ekonominë shqiptare”, nënshkruar më 18.4.2017 dhe publikuar në adresën e internetit:

https://www.bankofalbania.org/web/pub/memorandumi_gksf_9384_1.pdf

Përmbajtja

I. Hyrje.....	3
II. Përmbledhje.....	3
III. Ecuria e treguesve.....	4
IV. Konkluzion	12
Aneks I. Paketa e masave të Bankës së Shqipërisë në drejtim të deeuroizimit (Shkurt 2018), dhe treguesit e monitorimit	13
Aneks II. Veprime rregullative të mëparshme që ndikojnë në drejtim të deeuroizimit .	15

I. Hyrje

Referuar Memorandumit të Bashkëpunimit të datës 18 prill 2017, me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, Banka e Shqipërisë ka implementuar një paketë masash për të nxitur përdorimin e monedhës vendase. Kjo paketë, e cila u miratua me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë në shkurt 2018, përmban tre elemente kryesore: *i)* diferencimin e rezervës së detyrueshme për detyrimet në valutë dhe ato sipas afatit të maturimit në lek; *ii)* kërkesa më të larta për treguesit e likuiditetit në valutë; dhe *iii)* ndërgjegjësimin e huamarrësve për rrezikun që paraqet huamarrja në valutë. Vlerësimi i efikasitetit të masave realizohet nëpërmjet analizimit të disa treguesve të përzgjedhur për monitorimin e nivelit të euroizimit të sistemit financiar, duke krahasuar vlerat para dhe pas zbatimit të tyre. Më shumë detaje lidhur me masat dhe treguesit e përcaktuar për monitorimin e efektit të tyre jepen në Aneksin 1.

Rezultatet e kësaj analize dhe vlerësimi mbi përshtatshmërinë e masave për arritjen e objektivave të përcaktuar në memorandumimin e bashkëpunimit komunikohen çdo gjashtëmuor, përmes publikimit të këtij raporti.


Synimi i masave të zbatuara nga Banka e Shqipërisë nuk është arritja e nivelit zero të përdorimit të monedhave të huaja, pasi niveli i hapjes së ekonomisë sonë me vendet partnere tregtare nënkupton praninë e rëndësishme të monedhave të huaja në sistemin tonë financiar. Objektivi është ulja e masës së përdorimit të monedhave të huaja deri në një nivel që konsiderohet i natyrshëm për një ekonomi të ngjashme me atë shqiptare.

II. Përmbledhje²

Gjatë gjashtëmuorit të parë të vitit 2023, kur monitorohet ecuria e treguesve të përzgjedhur, bie në sy: rritja e peshës së aktiveve likuide në valutë ndaj detyrimeve afatshkurtra në valutë (që pakëson rrezikun e likuiditetit nga veprimtaria valutore); pakësimi i kredive në valutë në raport me totalin e kredive dhe vijimi i tkurrjes së kredive në valutë të ekspozuara ndaj kursit të këmbimit (që zbut kontributin e kursit të pafavorshëm të këmbimit në rrezikun e kreditit); rënia e lehtë e peshës së depozitave në valutë dhe rritja e mëtejshme e depozitave në monedhën vendase me afat mbi një vit, të cilat së bashku shprehin një dinamikë më pozitive për raportin mes monedhave në veprimtarinë e depozitave. Në përgjithësi, ecuria e treguesve gjatë periudhës vlerësohet në kahun e duhur për të arritur objektivat e synuar nga masat e deeuroizimit, ndonëse madhësia e ndryshimit është relativisht e vogël. Në terma vjetorë dhe më tej, shfaqet konsistenca në rënien e vlerës së kredisë në valutë të pambrojtur nga kursi i këmbimit, por dallimet në ecurinë e treguesve të tjerë janë më të mëdha, duke reflektuar nevojën për ruajtjen e një fokusi afatgjatë në vlerësimin e efekteve të masave të deeuroizimit dhe duke evidentuar larminë e faktorëve ekonomikë e socialë që mund të ndikojnë ecurinë e treguesve të përzgjedhur.

² Treguesit e monitoruar në këtë raport paraqiten të zhveshur nga efekti tremujor i luhatjeve në kursin e këmbimit të monedhës kombëtare ndaj monedhave kryesore të huaja (euro dhe dollar amerikan). Për matjen e efektit të kursit në portofolin e kredive të secilës bankë është përdorur formula: $X_t0 - X_{t-1} - (X_{t0}/K_{t0} - X_{t-1}/K_{t-1}) * K_{t-1}$. Ku, X përfaqëson vlerën në monedhën vendase, K është kursi i këmbimit i shprehur në lekë për njësi të valutës, dhe t është periudha e shprehur në tremujorë.

Grafik 1. Treguesit kryesorë për monitorimin e nivelit të përdorimit të valutës në sektorin bankar shqiptar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Shënim: Për secilin tregues, niveli i rrezikut është përcaktuar duke iu referuar një pragu krahasues. Për treguesit “depozita në valutë ndaj totalit të depozitave” dhe “kredi në valutë ndaj totalit të tepricës së kredisë”, pragu krahasues është niveli prej 30%, sipas gjykimit ekspert. Për vlera nën 30% të këtyre treguesve, niveli i rrezikut konsiderohet “i ulët” (ngjyra e gjelbër). Për treguesin “aktive likuide në valutë ndaj pasiveve afatshkurtra në valutë”, pragu krahasues llogaritet duke i shtuar një devijim standard të serisë kohore, kufirit rregullativ prej 20%. Për vlera më të ulëta se ky prag krahasues, treguesi sinjalizon “nivel të lartë” të rrezikut. Për treguesin e “depozitave me afat mbi një vit në lekë ndaj totalit të depozitave në lekë”, pragu krahasues është përcaktuar sipas gjykimit ekspert në nivelin 40%.

III. Ecuria e treguesve³

Analiza në vijim paraqet ecurinë e treguesve të listuar në Aneksin 1 të këtij materiali. Treguesit janë të zhveshur nga efekti i kursit të këmbimit, duke synuar zhvillimet reale dhe evidentimin sa më të saktë të ndikimit të masave. Siç vërehet në grafikët në vijim, zbatimi i paketës së masave ka pasur efekt gradual mbi treguesit e analizuar dhe ka qenë më i dukshëm në disa prej tyre.

Ecuria e Depozitave


Në fund të gjashtëmujorit të parë 2023, treguesi që mat *peshën e depozitave në valutë ndaj totalit të depozitave* shënoi nivelin 54.6%. Niveli i raportit ra me 0.3 pp krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe u rrit me 1.4 pp krahasuar me një vit më parë.

Për këtë raport, gjatë periudhës gjashtëmujore, depozitat në valutë (numëruesi) kanë shënuar rënie me 0.7%, ndërsa totali i depozitave (emëruesi) ka mbetur pothuaj i

³ Në këtë analizë janë rishikuar vlerat e T3 dhe T4 2018, për të reflektuar ndryshimet strukturore në sistemin bankar. Efekti i tyre ka qenë minimal dhe nuk ka pasur ndikim në konkluzionet e analizës.

pandryshuar (ka rënë lehtë me 0.1%). Në terma vjetorë, depozitat në valutë janë rritur me ritme më të larta, 9.2%, kundrejt rritjes së depozitave totale me 6.4%.

Grafik 2. Raporti i depozitave në valutë ndaj totalit të depozitave, për sistemin bankar




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në tërësi, shpërndarja e vlerave të treguesit për bankat jepet në Grafikon 3.

Kjo shpërndarje sipas bankave vijon të paraqitet relativisht simetrike duke u luhatur në nivelet 48.6% deri në 61.6%. Rezulton se 10 nga 11 bankat që operojnë në sistemin bankar regjistrojnë një vlerë të këtij treguesi mbi 50%, e cila potencialisht i bën ato subjekt të normës së rezervës së detyrueshme prej 20%. Ecuria në rritje e normave të interesit të valutës në tregjet ndërkombëtare mund të përmirësojë marzhin e përdorimit të valutës nga bankat dhe të shoqërohet me zbutjen e kostove të mësipërme.


Grafik 3. Shpërndarja e raportit të depozitave në valutë ndaj totalit të depozitave, për bankat e sistemit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Pesha e depozitave në lek me afat maturimi mbi një vit ndaj totalit të depozitave ka shënuar rritje gjatë periudhës me 0.5 pp, duke arritur në nivelin 17.6%. Në krahasim me një vit më parë, treguesi është rritur me 3.1 pp.


Grafik 4. Raporti i depozitave mbi një vit në lekë ndaj totalit të depozitave në lekë, për sistemin bankar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Shpërndarja e vlerave të këtij treguesi sipas bankave vijon të jetë e gjerë dhe reflektohet në vlerat e minimumit dhe maksimumit, të cilat luhaten nga 0.41% në 41.72%. Për 4 prej bankave, vlerat e treguesit kanë pësuar rënie dhe 6 banka kanë vlerën e raportit më të lartë se vlera mesatare e sektorit.

Grafik 5. Shpërndarja e raportit të depozitave mbi një vit në lekë ndaj totalit të depozitave në lekë, për bankat e sistemit



Burimi: Banka e Shqipërisë.


Rritja e vlerës së treguesit në dy vitet e fundit reflekton, nga njëra anë, rritjen e preferencës për depozitat më afatgjata në kushtet e rritjes së normave të interesit; nga ana tjetër, shpërndarja e gjerë e treguesit të peshës së depozitave në lek me afat maturimi mbi një vit ndaj totalit të depozitave, tregon që kjo zhvendosje përfaqëson një proces gradual dhe sfidues.

Ecuria e Aktiveve Likuide

Treguesi aktive likuide në valutë ndaj detyrimeve afatshkurtra në valutë vijon të mbetet mbi nivelet minimale rregullatore. Duke iu referuar këtij treguesi në nivel sektori, konstatohet se ai është rritur gjatë periudhës me 1.5 pp, duke u ngjitur në nivelin 28.7% në fund të qershorit 2023. Krahasuar me një vit më parë, treguesi është rritur me 2.7 pp.

Sipas elementeve përbërëse të raportit, vërehet se gjatë gjashtëmuajorit, aktivet likuide në valutë (numëruesi) janë rritur me 4.9%, ndërsa detyrimet afatshkurtra në valutë (emëruesi) kanë rënë lehtë me 0.4%. Sipas bankave, aktivet likuide kanë ndryshuar në intervalin [-12%] deri në 32.4%. Në krahasim me një vit më parë, aktivet likuide janë rritur me ritme më të larta se detyrimet afatshkurtra, përkatësisht 15.3% kundrejt 4.4%.


Grafik 6. Ecuria e treguesit të aktiveve likuide në valutë ndaj pasiveve afatshkurtra në valutë, për bankat e sektorit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Shpërndarja e vlerave të treguesit për valutën sipas bankave të sektorit (Grafiku 7) vijon të reflektojë një shpërndarje relativisht të gjerë. Për 3 prej bankave, vlerat e treguesit kanë pësuar rënie dhe 3 banka kanë vlerën e raportit më të lartë se vlera mesatare e sektorit.

Grafik 7. Shpërndarja e treguesit të aktiveve likuide në valutë ndaj detyrimeve afatshkurtra në valutë, për bankat e sektorit




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Ecuria e Kredisë

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2023, *pesha e portofolit të kredive në valutë ndaj totalit të kredive* ka shënuar rënie. Vlera e treguesit zbriti në 50.3% në fund të qershorit 2023, ose 1.7 pp më pak se në fund të dhjetorit 2022. Gjatë kësaj periudhe, kreditë në valutë shënuan rënie ndërsa kreditë në lekë vazhduan rritjen.


Grafik 8. Raporti i kredive në valutë ndaj totalit të kredive, për sektorin bankar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafiku 9, i cili paraqet shpërndarjen e peshave të kredisë në valutë në raport me totalin e kredisë për bankat e sistemit, tregon vijimin e ngushtimit të diferencës midis nivelit maksimal dhe atij minimal të vlerës së treguesit. Treguesi i kredive në valutë në raport me totalin e kredive ka shënuar rënie për pjesën më të madhe të bankave të sistemit, me përjashtim të dy prej tyre. Krahasuar me fundin e dhjetorit 2016, ky tregues është ulur për 10 nga 11 bankat e sistemit, në madhësi të ndryshme.


Grafik 9. Shpërndarja e raportit të kredive në valutë ndaj totalit të kredive, për bankat e sektorit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Nga ana tjetër, teprica e kredive në valutë të pambrojtura nga kursi i këmbimit, ku kreditë në euro zënë rreth 90%, ka shënuar rënie të mëtejshme të peshës ndaj totalit të kredive në valutë. Në fund të qershorit 2023, këto kredi shënuan 32.3% të kredive në valutë, ose 16.2% të totalit të kredisë. Në terma absolutë vërehet një rënie me 0.8% e kredive të pambrojtura ndaj kursit të këmbimit krahasuar me fundin e gjashtëmuorit të mëparshëm. Kreditë e ekspozuara ndaj rrezikut të kursit të këmbimit, domethënë rastet kur të ardhurat e subjektit huamarrës janë në monedhë të ndryshme nga monedha e dhënies së kredisë, janë ato me profilin më të lartë të rrezikut. Për këtë arsye, ky tregues mbart një rëndësi të veçantë në monitorimin e masave të deeuroizimit.


Grafik 10. Raporti i kredive në valutë të pambrojtura nga rreziku i kursit të këmbimit ndaj totalit të kredive në valutë, për sektorin bankar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në nivel bankash, treguesi shfaqet në përmirësim (rënie) për 5 nga 11 bankat e sistemit. Grafikut 11 paraqet shpërndarjen e këtij treguesi për bankat e sistemit, ku konstatohet që pjesa më e madhe e bankave kanë një vlerë të treguesit nën mesataren e sektorit. Shpërndarja e gjerë e treguesit ndikohet nga një numër i vogël bankash.

Grafik 11. Shpërndarja e peshës së kredive në valutë të pambrojtura nga rreziku i kursit të këmbimit ndaj totalit të kredive në valutë, për bankat e sistemit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Ecuria e Borxhit Publik


Transaksionet financiare të lidhura me huamarrjen e re në valutë, me shlyerjen e detyrimeve të borxhit në valutë dhe me përdorimin e të ardhurave valutore në ekonominë e vendit, të cilat shoqërohen me konvertim të valutës në monedhën vendase ose anasjelltas, ndikojnë në nivelin dhe ecurinë e përdorimit të valutës në vend. Për këtë arsye, ecuria e përbërjes së borxhit publik monitorohet si pjesë e kësaj analize.

Në fund të marsit 2023⁴, vërehet:

- 1) rritje e peshës së letrave me vlerë të borxhit (titujve) me maturitet 3, 6 dhe 12 muaj dhe rënie e peshës së letrave me vlerë të borxhit (titujve) me maturitet më të gjatë se 12 muaj (obligacione 2, 3, 5 dhe 7-vjeçare). Gjithashtu vërehet rritje e peshës së letrave me vlerë të borxhit (titujve) me maturitet afatgjatë, (obligacione 10 dhe 15-vjeçare);
- 2) një rënie e peshës së detyrimeve në valutë të qeverisë shqiptare krahasuar me fundin e shtatorit 2022.

Në fund të marsit 2023, borxhi publik në valutë zinte 47.4% të totalit të borxhit publik, duke u ulur me 2.9% krahasuar me gjashtë muajt paraardhës. Ai mbizotërohet nga borxhi në euro, i cili zë gati 72% të vlerës së borxhit në valutë.

Grafik 12. Ecuria e borxhit publik në lekë dhe valutë (boshti majtas), si dhe pesha e borxhit publik në lekë ndaj totalit (boshti djathtas)




Burimi: Të dhënat janë marrë nga faqja e internetit e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe janë përpunuar nga Banka e Shqipërisë.

⁴ Të dhënat më të fundit të publikuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë deri në momentin e publikimit të këtij raporti i referohen fundit të muajit mars 2023.

Ecuria e Kursit të Këmbimit

Gjatë periudhës janar - qershor 2023, lëvizja e kursit të këmbimit të monedhës vendase ka qenë më e shpejtë krahasuar me periudhat e kaluara. Kundrejt euros, leku është mbiçmuar me 6.7%, duke reflektuar nivelet e mira të flukseve hyrëse të valutës në ekonomi gjatë periudhës, kryesisht në formën e të ardhurave nga turizmi, remitancat dhe investimet e huaja direkte, si edhe përmirësimi i bilancit tregtar.

Grafik 13. Ecuria e kursit të këmbimit të lekut ndaj dy valutave kryesore



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Monedha vendase u mbiçmuar edhe ndaj dollarit amerikan me 8.7% krahasuar me fundin e vitit të kaluar. Krahas faktorëve të brendshëm të përmendur më sipër, kjo ecuri ka reflektuar edhe zhvillimet në tregjet ndërkombëtare. Në përgjithësi, USD është tregtuar në nivele më të dobëta ndaj Euros për shkak të perceptimit mbi fazat e ndryshme të normalizimit të politikës monetare në të dy blloqet.

Në situata kur kursi i këmbimit është i qëndrueshëm dhe luhatshmëria e tij është e ulët, agjentët ekonomikë kanë tendencën të rrisin volumin dhe frekuencën e transaksioneve të tyre financiare në valutë. Kjo shoqërohet në përgjithësi me rritje të shkallës së përdorimit të valutës dhe ulje të vigjilencës ndaj rreziqeve që shoqërojnë ekspozimin e agjentëve ndaj saj. Si rezultat, lëvizjet e papritura në kursin e këmbimit mund të nxisin transaksione të sforcuara në tregje nga ana e agjentëve, të cilat mund të rrisin pasigurinë për zhvillimet e përgjithshme ekonomike. Ndaj është e rëndësishme që në situata të zhvillimeve normale, të tërhiqet vëmendja e agjentëve ekonomikë për nevojën e kontrollit mbi nivelin dhe pozicionin e tyre në valutë, duke theksuar që kursi i këmbimit të lekut është i lirë dhe lëvizjet e tij në të dy kahet janë të mundshme. Në nivel makro, fleksibiliteti i kursit të këmbimit është një mekanizëm i rëndësishëm mbrojtës për zbutjen e goditjeve makroekonomike.

IV. Konkluzion

Në gjashtëmuojorin e parë të vitit 2023, mbiçmimi i lekut ndaj valutave kryesore ka qenë i ndjeshëm dhe më i shpejtë se në periudhat e mëparshme. Megjithatë, edhe kur korrektohen për këtë ecuri të kursit të këmbimit, ecuria e treguesve që monitorohen për të vlerësuar efektet e masave të deeuroizimit ka qenë përgjithësisht në përputhje me objektivat e synuar. Disa prej tyre, si pesha e depozitave në lekë me afat mbi një vit dhe pesha e depozitave në valutë, kanë shënuar përmirësime të lehta. Ndërsa, pjesa tjetër e treguesve, ku përfshihet pesha e kredive në valutë, ka shënuar përmirësime më të dukshme. Në terma vjetorë, ecuria e treguesve është më e larmishme por ende mund të dallohet prirja përmirësuese në shumicën e tyre. Ndryshimet strukturore në ekonomi gjatë viteve të fundit, ku veçohet rritja e fortë e turizmit dhe zhvillimet inflacioniste, janë shoqëruar me ndryshime të politikave ekonomike dhe monetare, si dhe të sjelljes së agjentëve të ekonomisë reale. Për këto arsye, është rritur vështirësia për dallimin e efekteve që lidhen ngushtë me masat e deeuroizimit. Gjithsesi, këto masa kanë efekt frenues në ecurinë e euroizimit dhe në mungesë të tyre madhësia e lëvizjes së ndonjërit prej treguesve, apo edhe kahu i saj, do të ishte e ndryshme.

Aneks I. Paketa e masave të Bankës së Shqipërisë në drejtim të deeuroizimit (Shkurt 2018) dhe treguesit e monitorimit

Masa 1. Për të rritur peshën e monedhës vendase dhe njëkohësisht zgjerimin e maturitetit në strukturën e detyrimeve të sistemit bankar, **Banka e Shqipërisë vendosi të diferencojë normën e rezervës së detyrueshme⁵**, për kategoritë e përfshira në bazën e rezervës së detyruar, si vijon:

- 7.5% (nga 10% që ishte më parë) për detyrimet në lekë me afat maturimi jo më të gjatë se 12 muaj;
- 5% (nga 10% që ishte më parë) për detyrimet në lekë me afat fillestar më të gjatë se 12 muaj deri në 2 vjet;
- 12.5% (nga 10% që ishte më parë) për detyrimet në valutë, kur këto zënë nën 50% të totalit;
- 20% (nga 10% që ishte më parë) për pjesën e detyrimeve në valutë mbi 50% të totalit.

Monitorimi i efekteve të Masës 1 bëhet nëpërmjet treguesve në vijim:

- *raportit të depozitave në valutë, të zhveshur nga efektet e kursit të këmbimit ndaj totalit të depozitave;*
- *raportit të depozitave mbi një vit⁶ në lekë, ndaj totalit të depozitave në lekë;*
- *ecurisë së strukturës së borxhit publik.*

Masa 2. Për administrimin më të kujdesshëm të rrezikut të likuiditetit, **Banka e Shqipërisë vendosi të rrisë kërkesën minimale rregullative për aktivet likuide në valutë⁷** në nivelin 20% të detyrimeve afatshkurtra. Për aktivet likuide në lekë, raporti u ruajt në nivelin prej 15%.

Monitorimi i efekteve të Masës 2 do të bëhet nëpërmjet treguesit në vijim:

- *raporti i aktiveve likuide në valutë ndaj detyrimeve afatshkurtra në valutë, të zhveshura nga efekti i kursit të këmbimit.*

⁵ Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 13, datë 7.2.2018, “Për miratimin e normës së rezervës së detyruar mbajtur në Bankën e Shqipërisë nga bankat”.

⁶ Ky tregues u konvertua për të shfaqur ecurinë e peshës së depozitave në lekë mbi një vit, si synim i drejtpërdrejtë i uljes së normës së rezervës së detyrueshme në lek.

⁷ Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 14, datë 7.2.2018, “Për një ndryshim në rregulloren për administrimin e rrezikut të likuiditetit”.

Masa 3. Për rritjen e ndërgjegjësimit të huamarrësve në lidhje me rrezikun e kursit të këmbimit, Banka e Shqipërisë u ka kërkuar bankave⁸ që:

- në rastet kur klienti aplikon për kredi në monedhë të ndryshme nga monedha në të cilën ka të ardhurat, bankat t'i propozojnë huamarrësit një kredi alternative në të njëjtën monedhë me të ardhurat e tij, si dhe ta pajisin atë me një shembull konkret se si ndryshon kësti i kredisë në rast nënçmimi të lekut dhe/ose rritjeje të normës së interesit (me vlera të përcaktuara);
- të përfshijnë në kontratat e reja të kredisë në valutë (apo ato që ristrukturohen rishtas), opsionin për përdorimin e mekanizmave që zbusin rrezikun e tregut për kredimarrësin, në rastin kur plotësohen kushtet e dakordësuara nga banka dhe huamarrësi.

Monitorimi i efektit të Masës 3 bëhet nëpërmjet treguesve në vijim:

- *kredia në valutë ndaj totalit të portofolit, zhveshur nga efekti i kursit të këmbimit;*
- *kredia në valutë e pambrojtur nga kursi i këmbimit, ndaj totalit të kredive në valutë, zhveshur nga efekti i kursit të këmbimit;*

⁸ Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 15, datë 7.2.2018, “Për disa ndryshime në rregulloren mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare e financiare”.

Aneks II. Veprime rregulative të mëparshme që ndikojnë në drejtim të deeuroizimit

Nr.	Masa	Data e adoptimit/e zbatimit	Përshkrim
1.	Kufizimi i huave në valutë të pambrojtura nga rreziku i kursit të këmbimit	Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës nr. 62, datë 14.9.2011, “Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja”, neni 15	Huatë në valutë, të dhëna për huamarrësit e pambrojtur nga rreziku i kursit të këmbimit (pra, ku të ardhurat e huamarrësit janë në lekë), nuk duhet të kapërcejnë nivelin 400% të vlerës së kapitalit rregullator të bankës. Çdo vlerë mbi këtë nivel, zbritet nga vlera e kapitalit rregullator.
2.	Kërkesa minimale për aktive likuide në valutë	Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës nr. 75, datë 26.10.2011, dhe nr. 28, datë 27.3.2013	Vendosja e një kërkesë minimale për vlerën e raportit të aktiveve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra, në nivelin 15%, e zbatueshme veçmas për lekun dhe për valutat kryesore (euro, dollar amerikan), dhe në total në nivelin 20%.
3.	Kërkesa më e lartë për kapital, lidhur me huatë në valutë të pambrojtura nga rreziku i kursit të këmbimit	Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës nr. 48, datë 31.7.2013, “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”	Huatë në valutë ndaj huamarrësve të pambrojtur nga rreziku i kursit të këmbimit, ponderohen me koeficient më të lartë rreziku (150%), për qëllime të llogaritjes së treguesit të mjaftueshmërisë së kapitalit të bankës.